



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

THIRRJE PËR PJESËMARRJE

NË

KONFERENCËN E TRETË NDËRKOMBËTARE STUDENTORE

"Inovacioni i udhëhequr nga studentët: Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme"

DHE

SIMPOZIUMIN E KARRIERËS DHE AFTËSIVE

25-26 Prill 2024

Elbasan

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Elbasan, 25-26 Prill 2024

Kemi kënaqësinë të ftojmë të gjithë studentët që të dërgojnë punimet e tyre për Konferencën e 3-të Ndërkombëtare Studentore me temë " Inovacioni i udhëhequr nga studentët: Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme", e cila do të mbahet në Universitetin e Elbasanit, "Aleksandër Xhuvani, më 26 prill 2024.

Inovacioni i udhëhequr nga studentët shërben si burim i rëndësishëm për të përmirësuar dhe transformuar shoqërinë tonë. Në këtë rrugëtim të ri, studentët marrin drejtimin dhe krijojnë ndryshime inovative në mjedisin e tyre të mësimin. Ky angazhim i tyre i palëkundur ndërthurur me kreativitetin shërben për të ndryshuar paradigmat dhe krijon mundësi të reja. Në këtë kontekst, inovacioni i udhëhequr nga studentët është mjeti kryesor për të fuqizuar gjeneratën e ardhshme të krijuesve të ndryshimeve. Kjo përpjekje e përbashkët për të eksploruar, zhvilluar dhe zbatuar ide inovative nxit shpirtin e sipërmarrjes dhe aftësinë për të shikuar përtej sfidave të zakonshme. Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme të krijuesve të ndryshimeve përmes inovacionit studentor shtron themelet e një shoqërie më të zhvilluar dhe të përmirësuar. Në këtë rrugëtim, studentët fitojnë njohuri të thelluara, zhvillojnë aftësi të reja dhe kultivojnë një kulturë të hulumtimit dhe eksperimentimit.

Objektivi kryesor i Universitetit të Elbasanit është të përgatisë profesionistë të aftë për t'u përballur me sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave humane, shkencave natyrore, ekonomisë dhe arsimit, si dhe shkencat mjekësore teknike.

Organizimi i kësaj konference është një mundësi e mirë, jo vetëm për të pasuruar përvojën akademike me metoda të vlefshme kërkimi, por edhe për t'u angazhuar brenda komuniteteve të studentëve, pavarësisht prejardhjes dhe perspektivave të tyre.

Pjesëmarrësit

Të gjithë studentët e interesuar të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve në Universitetin e Elbasanit dhe të mbarë universiteteve të tjera partnere kombëtare dhe ndërkombëtare janë të ftuar të marrin pjesë në Konferencën e 3-të Shkencore Studentore “Inovacioni i udhëhequr nga studentët: Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme”. Inkurajojmë të gjithë studentët që kanë përfunduar punimin e diplomës ose të mikrotezës, apo që janë të përfshirë në një projekt kërkimor shkencor me këmbënguljen dhe besimin për realizimin e këtij projekti brenda afateve të përcaktuara në këtë thirrje.

Qëllimi i konferencës:

Qëllimi kryesor i kësaj konference është të kontribuojë në rritjen e rolit dhe potencialit të studentëve në ndryshimet inovative në shoqëri dhe të përcaktojë se si ky inovacion mund të kontribuojë në krijimin e ndryshimeve pozitive në të ardhmen.

Objektivat e konferencës:

Konferenca synon të nxisë, motivojë dhe udhëzojë studentët në të menduarit kritik; t'i përfshijë ata në diskutime e debate për çështje e tema aktuale e ndërdisiplinore, duke promovuar aftësi dhe shprehje të tyre në fushën e kërkimit shkencor; të rrisë e forcojë bashkëpunimin e frytshëm për të zhvilluar e kultivuar aftësi e shprehje të qëndrueshme e të përparuara në fushë të kërkimit shkencor e më gjerë.

Objektivat specifike për këtë konferencë janë si më poshtë:

- nxitja dhe inkurajimi i studentëve për të zhvilluar dhe prezantuar projekte inovative në fushat e tyre të studimit;
- kontribuimi për të zgjeruar e përmirësuar aftësitë praktike të studentëve në kërkimin e tyre të pavarur shkencor;
- zhvillimi dhe përmirësimi i aftësive të studentëve për të identifikuar sfidat, zhvilluar zgjidhje inovative, dhe realizuar projekte praktike.
- mundësimi i iniciativave për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve dhe universiteteve në vendin tonë, në rajon e më gjerë.

Tematikat e konferencës:

Tematika e kësaj konference mbështetet dhe fokusohet në:

- a) Shkencat Humane dhe Shoqërore;
- b) Shkencat e Natyrës;
- c) Shkencat e Edukimit;
- d) Shkencat Ekonomike;
- e) Shkencat Mjekësore Teknike.

Në konferencë punimi mund të paraqitet në formë:

- shkrimi akademik;
- eseje.

Botimet e konferencës

- Bordi shkencor do të përzgjedhë punimet më të mira mbi bazën e përkatësisë së tematikës, qartësisë së mendimit dhe argumentimit, risisë dhe origjinalitetit të punës kërkimore e shkencore. Kto punime të përzgjedhura do të botohen në revistën e universitetit të quajtur Edicioni Special.
- Abstraktet e punimeve të pranuar do të botohen në Librin e Akteve të Konferencës (proceedings) me ISBN.

Seancat që do të mbahen në konferencë:

- seanca plenare;
- sesionet tematike.

Data të rëndësishme për konferencën:

Dërgimi i abstraktit	15.03.2024
Dërgimi i prezantimit power point	15.03.2024
Data e konferencës	26.04.2024

INFORMACIONE PLOTËSUESE

Gjuha e konferencës: në gjuhën shqipe dhe angleze

Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit.

Format e prezantimit të punimeve:

- prezantim verbal;
- prezantim me Power point.

SIMPOZIUMI I KARRIERËS DHE AFTËSIVE

Kemi kënaqësinë të ftojme të gjithë studentët që të dërgojnë punimet e tyre, si: piktura, skulptura, fotografi, grafika etj., për të marrë pjesë në Simpoziumin e Karrierës dhe Aftësive me temë "Inovacioni i udhëhequr nga studentët: Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme", i cili do të mbahet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", më **25 prill 2024**.

Ekspozimi i punimeve, do të zhvillohet njëkohësisht me Konferencën e 3-të Ndërkombëtare Studentore dhe do të ketë në fokus, prezantimin e punimeve artistike, grafike dhe inovative të realizuara nga studentët. Të gjitha punimet do të ekspozohen dhe do të vlerësohen nga ekspertët. Gjithashtu, do të organizohet ceremonia e dhënies së çmimeve.

Pjesëmarrësit

Inkurajojmë të gjithë studentët e interesuar të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve në Universitetin e Elbasanit dhe të mbarë universiteteve të tjera partnere kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë punime artistike, si: piktura, skulptura, fotografi apo punime grafike, inovative etj., brenda afateve të përcaktuara në këtë thirrje të marrin pjesë në Simpoziumin e Karrierës dhe Aftësive.

Qëllimi i Simpoziumit

Qëllimi kryesor të nxisë aftësitë kreative të studentëve, të këshillojë dhe orientojë studentët drejt rritjes së tyre, si dhe të krijojë kontakte të drejtpërdrejta me punëdhënësit potencial e të nxisë punësimin e tyre.

Objektivat e Simpoziumit

Simpoziumi synon të nxisë, motivojë dhe udhëzojë studentët të jenë pjesëmarrës aktiv në shoqëri, duke promovuar aftësitë dhe shprehitë e tyre kreative; të rrisë e forcojë bashkëpunimin me institucionet publike dhe private për të mundësuar rritjen profesionale deri në punësimin përfundimtar të të rinjve.

Objektivat specifike për përmbushjen e qëllimit të këtij Simpoziumi:

- nxitja dhe inkurajimi i studentëve për të zhvilluar dhe prezantuar aftësitë e tyre kreative nëpërmjet punime artistike, grafike, inovative etj.;
- nxitja e studenteve për t'u bërë pjesë e praktikave të punës në institucionet publike dhe private;
- krijimi i mundësisë për studentët për të kontaktuar nga afër bizneset që lidhen me profilin e tyre të studimit;
- të organizohet një panel me drejtues të institucioneve më të rëndësishme lokale dhe kombëtare për të promovuar, këshilluar dhe orientuar drejt të gjitha mundësive që ofrohen për studentët.

Tematikat e Simpoziumit

Tematika e këtij Simpoziumi mbështetet dhe fokusohet në:

- a) orientimin për karrieren;
- b) nxitjen e aftësive të ndryshme kreative;
- c) rritjen e mundësive për punësim.

Aktivitetet që do të mbahen në Simpozium:

- panair;
- konkurs me punime artistike, grafike, inovative etj.;
- diskutime në panel.

Data të rëndësishme për Simpoziumin:

<i>Dërgimi i punimeve</i>	10.04.2024
<i>Data e Simpoziumit</i>	25.04.2024

Vendi: Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Ju jemi mirënjohës gjithashtu, nëse ju e ndani këtë Thirrje për Pjesëmarrje në Konferencë dhe Simpoziumin e Karrierës dhe Aftësive edhe me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj.

Ju falënderojmë për interesimin tuaj!

Për dërgimin e materialeve, si dhe çdo pyetje lidhur me Simpoziumin, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni:

adresa e email: konferenca.studentore@uniel.edu.al

Ju falënderojmë për interesimin dhe angazhimin tuaj!

FORMATI I PUNIMIT

Punimi i plotë duhet të dërgohet në format elektronik në adresën e [konferenca studentore@uniel.edu.al](mailto:konferenca.studentore@uniel.edu.al) në formatin e kërkuar si më poshtë, si dhe i shoqëruar me figurat (fotografitë) me cilësi të mirë (në qoftë se ka të tilla).

Punimi nuk duhet të jetë botuar më parë, në asnjë revistë tjetër apo proceedings brenda dhe jashtë vendit.

Gjatësia dhe madhësia e punimit:	Punimi duhet të shkruhet në Microsoft® Office Word 97-2003 . I gjithë punimi duhet të jetë 3000 – 5000 fjalë.
Gjuha e punimit:	<p>Punimi duhet të shkruhet në gjuhën shqipe të saktë dhe të kuptueshme duke shmangur përdorimin e fjalëve të huaja. Në rast se është domosdoshmëri përdorimi i tyre atëherë është e nevojshme të përkthehen në kllapa ose në “footnote”. Sigurohuni që dorëshkrimi juaj të jetë kontrolluar nga ana drejtshkrimore dhe gramatikore para dorëzimit. Autori duhet të shkruajë si rregull në vetën e tretë duke përdorur si shprehje, si: quhet, kosiderohet, arrihet, në përfundim se, vërtetohet se etj.</p> <p>Janë të pranueshme edhe dorëshkrime në gjuhën angleze, kur cilësia e gjuhës plotëson kërkesat, dhe teksti është redaktuar më parë nga një person i autorizuar për gjuhën angleze.</p>
Fonti:	Times New Roman, single line (vijëzimi justified) Shënim: Vijëzimi Justify mund të aktivizohet dhe duke përdorur CTRL+ J
Formatimi i punimit:	Font: 11 Orientation: Portrait Page Layout - Size: B5(JIS), 7,17" x 10,12 Page Layout - Margins: Moderate 1" x 1", 0,75" x 0,75" Text Alignment: Justified Line Spacing: 1,15 <ul style="list-style-type: none">• Mos vendosni numër faqesh.• Mos e formatoni tekstin në kolona të shumta.• Mos lini paragrafë. Linjat bosh duhet të lihen vetëm nëse është e nevojshme.• Mos përdorni hapësira të shumta.
Organizimi i punimit:	Elementet që duhet të përmbajë një punim: <ul style="list-style-type: none">• Titulli, autori/ët dhe përkatësitë• Abstrakti dhe fjalët kyçe• Hyrja• Materiale dhe metoda• Rezultatet• Diskutim• Përfundime/ Konkluzione• Referencat/Literatura• Shtojca (t) (nëse aplikohet)

Titulli:	<ul style="list-style-type: none"> • Titulli duhet të jetë specifik, korrekt, i kuptueshëm dhe të përçojë idenë qendrore të punimit për lexuesit jashtë fushës. • Titulli duhet të shtypet me germa KAPITALE me font 14 dhe me Bold (germa të theksuara). Titulli i punimit nuk duhet të ketë më shumë se 250 karaktere. • Pas titullit vendosen emrat e autorëve me font 12 dhe me Bold, institucionet përkatëse dhe adresat e plota të tyre me Font 10 dhe Italic • Titulli, autori/ët dhe adresat vendosen në qendër.
Autori/ët:	<p>Të gjithë individët që kanë dhënë një kontribut thelbësor në artikull duhet të listohen si autorë. Ju lutemi shkruani emrin dhe mbiemrin e autorëve, si dhe përkatësinë. Përkatësia përfshin programin e studimit, universitetin ose vendndodhjen e tij, duke përfshirë qytetin, shtetin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mos listoni gradat akademike, adresat personale dhe e-mailet. • Emri mbiemri i autorit/ëve duhet të shkruhen me Font 12 Bold. • Përkatësitë e autorit/ëve duhet të shkruhen me font 10 dhe Italic.
Përmbledhja / Abstrakti:	<p>Abstrakti duhet të përshkruajë objektivin (at) kryesorë të studimit, të shpjegojë se si është kryer studimi dhe të përmbledhë rezultatet më të rëndësishme dhe rëndësinë e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Abstrakti nuk duhet të kalojë 300 fjalë ose të përfshijë citime. • Në punimet në gjuhën shqipe përmbledhja/abstrakti duhet të paraqitet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. • Përmbledhja/abstrakti duhen me Font 11 dhe Italic.
Fjalët kyçe:	<ul style="list-style-type: none"> • Punimi duhet të ketë jo më shumë se 5-7 fjalë ose fraza kryesore kyçe të cilat pasqyrojnë thelbin e punimit. • Fjalët kyçe ose frazat kryesore duhet të ndahen me presje. • Vetëm emrat, mbiemrat dhe shkurtesat e duhura duhet të shkruhen me shkronja të mëdha.
Titujt dhe nëntitujt e punimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Titujt shkruhen me shkronja të mëdha, shkronja të zeza (Bold), pas një rreshti bosh. • Nën-titujt shkruhen me shkronja të pjerrëta, me fjali. Ato numërohen duke përdorur numra arabë (1, 1.1, 1.2, 1.2.1..., 2, 2.1...). • Kufizoni pjesët dhe nën-seksionet e dorëshkrimeve në 3 nivele titulli.
Punimi:	<p>Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë së problemit që do të jetë në qendër të punimit. Hyrja duhet të përshkruajë shkurt bazën për punën e paraqitur. Në hyrje tregohen objektivat dhe arsyet e ndërmarrjes së studimit, struktura e punimit, si dhe shkurtimisht rezultatet e marra, diskutimet e kryera dhe të rejat që sjell punimi.</p> <hr/> <p>Sfondi teorik: Në këtë pjesë bëhet një përshkrim i përgjithshëm i rishikimit të literaturës dhe vendoset tema e propozuar. Në punën kërkimore gjithnjë fillohet prej një baze teorike që është mbizotëruese në një fushë të caktuar shkencore.</p> <hr/> <p>Formulimi i problemit dhe qëllimeve të punimit: Problemi shkencor duhet të përkufizohet qartë, saktë dhe mirë. Qëllimet e punimit duhet të jenë të harmonizuara me problemin. Parashtrimi i problemit edhe nëse ai qëndron si i tillë, duhet të jenë të lidhura kuptimisht me qasjen teorike, por edhe me hipotezat dhe metodat e parashikuara të kërkimit.</p>

Pyetjet dhe hipoteza: Pyetja e punimit duhet të formulohet qartë. Ajo duhet të nënkuptojë një hipotezë kërkimi që mund të verifikohet. Hipoteza e kërkimit duhet të jetë e formuluar saktë, në mënyrë që të shmanget dykuptimësia dhe kërkesat shtesë. Është e rëndësishme që gjetjet të paraqiten në mënyrë të tillë që mund të arrihet në përfundime. Në kërkimet cilësore është e rëndësishme që të kuptohen drejt dukuritë e hulumtuara dhe të tregohet se përvojat që pasqyrohen në to ndihmojnë të kuptuarit dhe lejojnë mbërritjen në përfundime të caktuara. Nëse përdorim kërkime sasiore apo një përzierje të të dyjave, është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohet një numër kriteresh përmes së cilave një hipotezë pohohet ose mohohet.

Materiali dhe Metoda duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar. Këtu paraqiten metodat e ndryshme të përdorura në studim, si dhe ato statistikore. Informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë referimet.

Rezultatet dhe diskutimet duhet të jenë të qarta dhe të ilustruara në tabela dhe grafikë. Rezultatet eksperimentale duhet të analizohen statistikisht dhe të nxirren përfundime në bazë të një besueshmërie statistikore. Të njëjtat rezultate të dhëna me tabela nuk mund të jepen edhe me anën e grafikëve dhe anasjelltas.

Konkluzionet: Konkluzionet që vijnë nga rezultatet e paraqitura duhet të diskutohen në mënyrë të plotë, të lidhen direkt dhe të mbështeten në rezultatet e arritura. Konkluzionet nuk duhet të jenë spekulative, të merren prej literaturës, njohurive të përgjithshme e spontane.

Tabelat:

- Përmasat e tabelave, figurave dhe fotografive nuk duhet të kalojnë përmasat **12 cm në gjerësi x 18 cm në gjatësi**.
- Tabelat duhet të vendosen në pikat e duhura të tekstit, midis paragrafëve, jo brenda tyre.
- Të gjitha tabelat duhet të kenë numrat dhe titujt e tabelave dhe duhet të referohen me numrin e tabelës në tekst.
- Numri dhe titulli i një table duhet të vendosen sipër, jashtë tabelës dhe në qendër të tabelës. Fonti 10, vetëm emërtimi i tabelës me Bold, dhe përshkrimi vetëm Italic. Shembull: **Tabela 1. Të dhënat e përgjithshme të studimeve**
- Tabelat duhet të ndërtohen përmes përdorimit të funksionit Tabelës në Microsoft Word dhe nuk duhet të përfshijnë imazhe ose objekte. Ato nuk duhet të përmbajnë hapësira të panevojshme. Tabelat që janë shumë të gjata ose shumë të gjera për një faqe të vetme mund të shtypen në një madhësi fonti më të vogël ose të vazhdojnë në faqen tjetër.

Figurat:

- Figurat, të cilat përfshijnë grafikë, tabela, harta, vizatime dhe fotografi, duhet të kenë një ndikim material në përmbajtjen e një artikulli dhe nuk duhet të përdoren për qëllime dekorative.
- Figurat duhet të vendosen në pikat e duhura të tekstit, midis paragrafëve, jo brenda tyre.
- Të gjitha figurat duhet të kenë numra dhe tituj figurash dhe duhet të referohen me numrin e figurës në tekst. Numri dhe titulli i figurës duhet të vendosen sipër dhe jashtë figurës. Fonti 10, vetëm emërtimi i figurës me Bold, dhe përshkrimi vetëm Italic. Shembull: **Figura 1. Të dhënat e përgjithshme të studimeve**
- Figurat duhet të jenë me cilësi të lartë dhe duhet të përshtaten në një faqe.

Akronimet:

Mos përdorni shkurtesa jo standarde nëse ato nuk shfaqen të paktën tri herë në tekst. Mbani shkurtime të minimum.

**Shënime /
Footnotes:**

Shënime janë të vendosura në fund të një faqeje. Ata citojnë referenca ose komentojnë një pjesë të caktuar të tekstit mbi të. Shënime i referohen burimeve përkatëse - ata i bëjnë të ditur lexuesit tuaj se nga ka ardhur një material i caktuar, ose ku mund të kërkojnë burime të tjera mbi këtë temë.

Referencat:

Referencat renditen në fund të punimit. Ju lutemi sigurohuni që çdo referencë e cituar në tekst të jetë gjithashtu e pranishme në listën e referencave (dhe anasjelltas). Rezultatet e pabotuara dhe komunikimet personale nuk rekomandohen në listën e referencave.

Citimet e literaturës përgjatë artikullit duhet të bëhen duke përdorur emrin e autorit, të dy autorëve, ose të autorit të parë: p.sh. në përdorimin drejtpërdrejt në periudhë: Uherkovich (1963); Brakefield & Dowdeswell (1985); Van den Hoek et al. (1995); ndërsa në citimin e përgjithshëm: (Uherkovich, 1963; Brakefield & Dowdeswell, 1985; Van den Hoek et al., 1995). Literatura duhet të shkruhet qartë dhe e plotë, gjithë autorët, titulli i plotë, emri kuptueshëm i botuesit dhe faqet, si më poshtë (për librat dhe artikujt shkencorë përkatësisht):

Literatura në fund të artikullit:

Brakefield P. M. (1982): The ecological genetics of quantitative characters of *Maniola jurtina* and other butterflies. In: *The biology of butterflies. Symposia of the Royal Entomological Society, London. No. 11: 167-190*

Brakefield P. M., Dowdeswell W. H. (1985): Comparison of two independent scoring techniques for spot variation in *Maniola jurtina* (L.) and the consequences of some differences. *Biol. J. Linn. Soc. 24: 329-345*

Uherkovich G. (1963): Contributions a' la connaissance du potamo-phytoplancton de quelques fleuves de l'Albanie. *Acta Botanica, Ac. Sci. Hungaricae, vol. 9: 161-172*

Për një sistem referimi korrekt dhe të unifikuar do sugjeronim të përdorni Mendeley Reference Manager ose paketa të tjera të menaxhimit të referencave të cilat ndihmojnë në menaxhimin dhe shkrimin e referencave. Për më shumë detaje ndiqni guidën <https://www.mendeley.com/guides/apa-citation-guide>.